REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br: 133/17
Date/Datum: 30.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Korporata Energjetike e Kosoves"** sha.	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **133/17**, parashtruar nga OE , **NTSH „Ekoinvest"**, - Prishtinë.		
Datë:	**30.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me platformë transportuese**", me nr. të Prokurimit: **KEKO /16/399/111**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Korporata Energjetike e Kosoves"** sha., dhe me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: NTSH **"Ekoinvest"- Prishtinë,** me nr**133/17,** të datës **08.05.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Korporata Energjetike e Kosoves sha".**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - **"NTSH „Ekoinvest",** - Prishtinë,

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		22.05.2017		**25.05.2017**		**30.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **08.05.2017,** Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **133/17**, e parashtruar nga OE **NTSH „Ekoinvest",** - Prishtinë, kunder AK – **Korporata Energjetike e Kosoves** sha, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me platformë transportuese**", me nr. të Prokurimit: **KEKO /16/399/111.**
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) –**Korporata Energjetike e Kosovës sha.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues NTSH **„Ekoinvest",** - Prishtine

Pikat e Ankesës nga OE NTSH **„Ekoinvest",,** nga Prishtina, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7, 10, 11 dhe 59, te LPP-se, dhe neni 18 dhe 39, te UOPP-se

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me date 20.04.2017, jemi njoftuar per tenderuesin e pasuksesshem 1)81 projektin ne "Furnizim me platforme transportuese". NE te njejten dite kemi kerl uar qasje ne dokumentacionin tenderik, cila na Eshte mundesuar me date: 21.04.2017.

Gjate qasjes ne dokumentacionin tenderik nuk na Eshte lejuar qasja e pakufiziuar ashtu siq e parashohin dispozitat ligj ore, perkatesisht neni 10 i Lpp-se — Mjetet per promovimin e transparaences.

Neve na eshte lejuar qasj a vetem ne formularin e tenderit e cila eshte e perbe 6 nga Pjesa C dhe lista e cmimeve.

Perr kete ceshtje dhe disa te tjera ne kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim pi and AK KEK, mirepo kerkesa jone refuzuar si e pabazuar.

Ne ato pak dokumente ne te cilat na eshte ofruar qasje, kemi verejtur shkel e flagrante te neneve 59 te Lpp-se, 18 te Rregullave dhe UOPP-se si dhe nenit 39 te Rregullave dhe UOPPse, per falctin se komisioni i vleresimit te AK nuk i ka respektuar dispozitat ne fjale me rastin e vleresimit te ketij tenderit.

OE i rekonaanduar per kontrate nuk e ka plotesuar Pjesa C: Formulari perr dorezimin e ofertes conform dispozitave ligjore dhe kerkesave te AK.

Ne Piken 7, te pjeses 1 Formularri I tenderit, aty ku kerkohet vendosja e numrit te loteve OE I rekomanduar ka vendosur nje numer I cili nuk korespodon edhe se e njejta kontrate nuk eshte e ndare ne lote.

Ner pjesa II. Pershkrimi i cmimeve, AK ka kerkuar qe te vendosen cmimet njesi per secilin 6 pozicionet. OE nuk i ka respektuar dispozitat ligjore dhe njeherit vete kerkesen e AK, duke mos e plotesuar listen e crnimeve per secilin pozicion ashtu sic eshte kerkuar ne dosje tenderit si dhe ashtu sic e parashohin dispozitat ligjore te Lpp-se.

Deshmia 1

Ne nenin 18 te RRUOPP-se, shume qart shkruan se OE duhet te plotesoje dhe te nenshkruaj formularin (dy pjeset), sepse ne qofte se formulari nuk eshte plotesuar kjo do te thote se nuk ka oferte.

Me kete rest

OE I rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar formularin e tenderit, perkatesisht listen e cmimeve duke mos I vendosur cmimet per njejsi ne te gjitha pozicionet e kerkuara nga AK KEK.

Deshmia 2

Per me teper, pergjegjeshmerin e OE te rekomanduar per kontrate e verteton edhe nenin 39, sqarimi I tendereve I rregullave dhe UOPP-se, ku ne menyre shprehimore I pershkruan situaten si te veprohet nga zyrtaret e AK-se

Situata 1.

<u>Mungon cmimi - refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem – kusht administrative.</u>

Situate 2,

<u>Formulari I tenderit nuk eshte plotesuar si duhet apo mungon – refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem – kusht administrative.</u>

Situate 3.

<u>Lista e cmimeve nuk eshte plotesuar – refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem – kusht administrative.</u>

Deshmia 3

Pra me kete rast komisioni i vleresimit eshte dashur ti respektoje dispozitat ligjore dhe ta refuzoje tenderin pasi qe OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka vendosur cmimet per njesi ne formularin e listes se cmimeve, dhe se eshte i papergjegjshem.
Duke u bazuar ne shkeljet e lartpermendura kerkojme nga OSHP qe te anuloje vendirnin per dhenie te kontrates, dhe te vazhdoje me rekomandimin e OE te radhes te pergjegjeshem.

Demet material:
Tani per tani te pa percaktuara.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	08.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	furnizim/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave pas njioftimit per info shtese	03.02.2017
Data e hapjes së ofertave pas njioftimit per info shtese	03.02.2017
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :	20.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. - Origjinal

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit
3. Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend /Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;

Kopja e numrit fiskal (nese nuk aplikohet ne vendin e themelimit deklaratë nën betim nga aplikuesii

mund të pranohet si dëshmi e nënshkruar dhe vërtetuar.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar - N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesat

1. Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë
2. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet
3. Katalogje të produkteve
4. Referenca

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni
2. Certifikatë Standard ISO 9001:2008 të prodhuesit për produktet e ofruara
3. Kalatogje dhe/apo pjesë të katalogut me pëshkrimet teknike detale për të gjithë artikujt që ofertoni. Në katalog/vizatim (specifikim) të nënvizohen artikujt që keni ofertuar për çdo pozicion të kërkuar në këtë DT

Një (1) referenca te ofertuesit të realizuara gjatë 3 viteve të fundit (2015, 2014 dhe 2013), të natyres dhe kapacitetit te ngjashëm.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"TAKREF" GmbH	Gjermani	2 570 040.00 €	JO
2.	"Thyssenkrupp Industrial Solution" AG	Gjermani	2 358 896.00 €	JO
3.	NTSH "Ekoinvest - FAM"	Kosovë - Gjermani	2 457 940.00 €	JO
4.	"KWE – DAM – MONT"	Kosovë - Serbi	1 397 592.00 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 03.02.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katër (4) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Emin Maxhuni
- - Anëtar i komisionit - Samir Mejzini
- - Anëtar i komisionit –Osman Berisha
- - Anëtar i komisionit - Albert Lahu
- - Anëtar i komisionit –Flamur bekteshi

Data e mbarimit të vlerësimit: 28.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....29.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Nga kater (40 oferta te paraqitura per kete tender, tri (3) oferta jane ne perputheshmeri te plote me kerkesat tona administrative, teknike dhe / apo profesionale.
Komisioni i vleresimit propozon qe oferta e pergjegjeshme me cmimin me te ulet e OE Thyssenkrupp Industrial Solution AG, te shperblehet me kontrate.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114),

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit – trajtimit të pretendimeve të palës, të përfshira në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1 Autoriteti Kontraktues - "Korporata Energjetike e Kosovës" sha, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: NTSH **"Ekoinvest"**, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënje të kontratës, të publikuar në ueb faqen e krpp-së më datën. **20.04.2017**.

Kundër të njejtit njoftim patrashtruesi i ankeses OE NTSH "Ekoinvest", sipas përshkrimit, më datën **25.04.2017**, ka paraqitur kërkesë për rishhqyrtim pranë AK –KEK, duke pretenduar se nuk janë respektuar dispozitat e nenit **7, 10, 11** dhe **59**, të LPP-së, si dhe nenit **18** dhe **39**, të rregullave të UOPP-së. AK - KEK, më datën **28.04.2017**, nxjerr vendim dhe refuzon si të pa bazuar kerkesën për rishqyritm me arsyetimin se AK, vlerësimin e ofertave e ka bërë në përputhëshmëri të plotë me kriteret dhe kushtet e dosjes së tenderit.

- Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënje të kontrates "Thyssenkrupp Industrial Solution" AG.

Sqarimi 2 Fillimisht sqarojmë se parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankes potencon se i është mohuar qasja e pakufizuar sipas nenit **10**, të LPP-së, në përjashtim të pjesës C- formulari i tenderit, dhe listës së çmimeve. Për të njejtën situatë sqarojmë se në shkresa të lëndës së AK-së ekziston shkresa, e nënshkruar nga përfaqesuesit e OE ankues, sipas përshkrimit në të potencohet se OE i rekomanduar për dhënje të kontratës e ka cilesuar si sekret afarist të gjithë dosjen e tenderitn duke mos i'u mundësuar qasja konform LPP-së në fuqi. Në anën tjetër përfaqesuesit e AK-së, sipas përshkrimit në po të njejtën shkresë kanë potencuar që OE, i rekomanduar për dhënje në ofertë ka kërkuar konfidencialitet të ofertës dhe se si AK, kanë spastruar oferten e të njejtit OE.

- Për të njejtën situatë sqarojmë se nenit **7**, paragrafi **5**, i rregullave të UOPP-së - legjislacion sekondar i nxjerrur nga KRPP, si informacione të cilat mund të klasifikohen si sekrete të biznesit parashef:

a) Informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68, i LPP-së;
b) Informacionet në lidhje me mundësit teknike dhe/ ose profesionale, neni 69 i LPP-së.

Pretendimi tjeter ka të bëjë me pjesen "**C** – formularin e tenderit", pjesë e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënje të kontratës. Sqarojme se i njejti formular (pjesa e parë) nuk përmban nënshkrim apo vulë, nga OE i rekomanduar për dhënje të kontratës. Sipas përshkrimit rezulton që e njejta shkresë të jetë nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit, rrjedhimisht veprimi si i tillë paraqet mos respektim të nenin **18**, paragrafi **3**, të rregullave të UOPP-së, ku shprehimisht thuhet: ***"...OE duhet të plotësoj dhe të nënshkruaj formularin (dy pjesët), sepse në qoftë se formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka***

ofertë...". Poashtu pika nr. **7** e të njejtit formular, pikë e dedikuar për përshkrim të "numrit të pjesës (lotit)", është përshkruar numri "**1-301-91098**", i cili nuk korespodon me numrin e këtijë aktiviteti të prokurimit "KEKC – 16-399-111", përkundër faktit që ky aktivitet i prokurimit nuk është i ndar në pjese (lote). Për më tepër forma tabelare e nenit **39.5**, poashtu e rregullave të UOPP-së, ku pershkruhet menyra se si duhet të trajtohen problemin gjegjesisht rekomandimi se si të veprohet potencon :

Problemi: - Formulari i tenderit nuk është plotësuar **si duhet** apo mungon,
Si të veprohet: - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm,
Neni i LPP-së: - Kusht administrativ.

Në vijim po sqarojmë pretendimin tjeter ankimorë të përfshirë në ankes, lidhur me pjesën II - Përshkrimi i çmimeve. AK - KEK, ka përshkruar gjithesej gjashtë (**6**) pozicione, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënje të kontratës, tek pozicioni nr. **3** "Spare parts catalogue in hard copy and CD", pozicioni nr. **4**, "Manual servicing per mechanical and manipulative in hard copy or CD", dhe **5**, "Operation manual in hard copy or CD", gjegjësisht tek rubrika e përshkrimit të çmimeve nuk ka ofruar vlerë – çmim, por ka potencuar se janë përfshir tek pozicioni nr. **1**. Për të njejtën situate sqarojmë së AK - KEK, në pozicionin **20, 1**, në dosje të tenderit "Informatat e përgjithshme", ka potencuar: "*Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në euro (€). Cmimi i ofruar lejohet që të shenohet në maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. Cdo mumer i shenuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofruar".* Poashtu neni **39.8** i rregullave të UOPP-së, pozicion tjetër i trajton edhe rastet e tilla:

Problemi: - Lista e cmimeve nuk eshte plotesuar,
Si të veprohet: - Refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem,
Neni i LPP-së: - Kusht administrativ.

Poashtu në ueb faqen KRPP-së, tek rubrika e pyetjeve të shpeshta, konkretisht kundrejt pyetjes me nr. 29, sqarohet procedura se si duhet të veprohet për këso rastesh dhe atë shprehimisht thuhet: "....*Nëse operatori ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet në Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e plotë të kontratës*..."

Prandaj, në mbështetje të asaj që u tha më lartë pretendimet e palës të përfshira në ankesë i kualifikojmë si të bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelin shqyrtues qe aktiviteti i prokurimit me titull "***Furnizim me platformë transportuese",*** me nr. të Prokurimit: KEKO **/16/399/111,** inicuar nga AK **Korporata Energjetike e Kosoves**, të **RI –VLERESOHET**, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik **NTSH "Ekoinvest"**, të miratohet si e **bazuar.**